



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 13.08.2025
Numër Protokoli: 5488/2025

A.nr.669/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.669/2025 të datës 17.04.2025 të parashtruar nga ankuesi H.H, kundër organit të punësimit/Ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*transferim si rezultat i rristurimit*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.08.2025 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.669/2025 e datës 17.04.2025 e parashtruar nga ankuesi H.H.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, H.H (*tani e tutje referuar: ankuesi*), me datë 17.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-182/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministra e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje MMPHI), ndërsa kjo e fundit më datë 15.07.2025 ka dërguar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.669/2025, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, sipas Aktit të Emërimit të datës 30.06.2014 është e punësuar në pozitën *Teknik për Mirëmbajtjen e Rrugëve* në MMPHI.

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Vendimit me Nr.073/2024 të datës 29.03.2024 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr.08/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me ç'rast procesi i organizmit të MMPHI, është pasuar me shuarje të pozitave, ndryshime në emërtime të pozitave përkatëse si dhe ndryshime në përshkrimin e detyrave dhe kriterëve të punës për pozita të caktuara.

Rrjedhimisht, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me Vendimin me Nr.2392/2024, të datës 29.11.2024, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për Ministrinë e Shëndetësisë, ku ky i fundit më datë 03.03.2025 ka miratuar Raportin përfundimtar lidhur me procesin e ristrukturimit në MMPHI, përmes të cilit ankuesin e ka propozuar të transferohet në pozitën Zyrtar Administrativ. Bazuar në këtë raport, Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB, më datë 18.03.2025 ka nxjerr Vendim MMPHI-182/2025, me të cilin ankuesin nga pozita Teknik për Mirëmbajtjen e Rrugëve e ka transferuar në pozitën Zyrtar Administrativ, në Divizionin e Zhvillimit të Rrjetit Rrugor.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit MMPHI-182/2025, të datës 18.03.2025, të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, pretendon duhet rishikohet sistemimi dhe të caktohet Zyrtar për Mirëmbajtje. Duke qenë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kishte pranuar disa ankesa të nëpunësve civilë të pakënaqur më procesin e ristrukturimit në MMPHI, Këshilli më Vendimin me numër A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025, ka aprovuar ankesën e datës 30.04.2025, të parashtruar nga të ankuesi B.T, duke shfuqizuar Raportin Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025 dhe të gjitha vendimet dhe procedurat që rrjedhin nga ky raport.

Referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.669/2025, të datës 17.04.2025, ka të bëjë më vendimin për transferim për shkak të ristrukturimit, vendim ky, i pasuar si veprim nga zbatimi i Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ristrukturimit në MMPHI të datës 03.03.2025, e duke qenë se ky akt është shfuqizuar si i paligjshëm me Vendimin A.nr.786/2025, të datës 11.08.2025 të KPMSHCK-së, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: "*Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot*". Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.669/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.669/2025, të datës 17.04.2025.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, me numër A.nr.669/2025.

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit H.H;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/MPB, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.